

PAULO COELHO
NJËMBËDHJETË MINUTA
ROMAN

BOTIMET TOENA

*Libra nga Paulo Coelho,
prej Shtëpisë Botuese TOENA*

- Alkimisti
- Mali i pestë
- Veronika vendos të vdesë
- Djalli dhe zonjusha Pym
- Njëmbëdhjetë minuta

Së shpejti:

- Manuali i luftëtarit të dritës

Paulo COELHO

Njëmbëdhjetë
minuta

■ *roman* ■

Përktheu:
Durim TAÇE

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2004

Titulli në origjinal
Paulo Coelho, Onze minutos

This edition published by arrangements
with Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L., Barcelona.
All rights reserved.

Botues dhe redaktor: Fatmir Toçi
Korrektore letrare: Elda Kelo
Përkujdesja grafike: Lavdie Cenmurati
Kopertina: Irena Toçi
Në kopertinë e parë: Jean Auguste Dominique Ingres,
La baignante di Valpinçon (fragment)

ISBN 99927 - 1 - 867 - 6

© Paulo Coelho (www.paulocoelho.com)
© Në gjuhën shqipe: Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA
Rr. "Muhamet Gjollësia", K.Postare 1420, Tiranë
Tel.: (355) (4) 240116; 240117
Tel./Fax: (355) (4) 240117
E-mail: toena@icc.al.eu.org
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

I kushtohet

Më 29 maj 2002, disa orë përpara se ta mbaroja këtë libër, pata shkuar në Grotta di Lourdes, në Francë, për të mbushur disa poça me ujë të bekuar nga burimi. Ndodhesha brenda rrethimit të katedrales, kur një zotëri rreth të gjashtëdhjetave më thotë: “A e di që i ngjakeni Paulo Coelho?” I them se jam dora vetë. Burri më përqafoi, më prezantoi gruan dhe mbesën. Tha se librat e mi kishin luajtur një rol të rëndësishëm në jetën e tij: “Më bëjnë të ëndërroj.”

Është një frazë që e kam dëgjuar shpesh dhe më mbush gjithnjë me gëzim. Në atë çast, megjithatë, mbeta pak i befasuar, duke e ditur se “*Njëmbëdhjetë minuta*” trajton një argument delikat, të ashpër, shokues. Eca drejt burimit dhe mbusha poçat; më pas, kur u ktheva, e pyeta atë njeri se ku banonte (në veri të Francës, në kufi me Belgjikën) dhe e mora emrin e tij shënim.

Këtë libër po ta kushtoj ty, Maurice Gravelines. Kam një detyrim për ty, për gruan tënde, për mbesën, por edhe për vetveten: flas për atë që më shqetëson e jo për atë që të tjerët kanë dëshirë të dëgjojnë. Disa libra na bëjnë të ëndërrojmë, të tjerë na sjellin realitetin – por asnjë prej tyre nuk mund t’i heqë autorit gjënë e tij më të rëndësishme: ndershmërinë me të cilën ai shkruan.

*Oh, Marie e ngjizur pa mëkatuar,
lutu për ne që përgjërohemi për Ty!
Amen.*

*Sepse unë jam e para dhe e fundit,
Jam e nderuara dhe e përçmuara,
Jam prostituta dhe shenjtorja,
Jam gruaja dhe virgjëresha,
Jam nëna dhe bija,
Krahët e nënës sime, jam unë,
Po, jam sterile, por fëmijë kam shumë.
Unë jam gruaja e martuar dhe beqarja,
Jam ajo që jep dritë e ajo që nuk sjell në dritë të tjerë,
Jam vetë lehtësimi i dhimbjeve të lindjes.
Unë jam nusja dhe dhëndri,
Dhe ishte burri im që më krijoi.
Unë jam nëna e babait tim,
Jam motra e burrit tim,
Ndërsa ai është biri im i mohuar.
Të më respektoni gjithmonë,
Sepse unë jam skandalozja dhe e mrekullueshmja.*

Himni i Iside-s, shek. III ose IV (?),
i zbuluar në Nag Hammadi

Një grua, mëkatore e atij qyteti, si e kishte marrë vesh që Jezusi ndodhej në shtëpinë e Fariseut, na vjen me një enë qelqi plot me vaj aromatik. E ndjek nga pas, i ulet pranë këmbëve e, duke qarë, ia lag ato me lot; pastaj ia than me flokët e saj, ia puth e ia spërkat me vajin aromatik. Duke parë këtë skenë, Fariseu që e kishte ftuar Jezusin mendoi me vete: “Po të jetë profet me të vërtetë do ta kishte marrë vesh se ç’palo grua po e prek me dorë, një mëkatore.”

*Jezusi në atë çast i tha: “Simon, desha të të them diçka.”
Ai ia ktheu: “Fol, o mjeshtër.”*

“Një huadhënës na kishte dy hua pa marrë: njëri i kishte pesëqind pare, tjetri pesëdhjetë. Si e pa që nuk kishin t’ia kthenin, ua fali huatë që të dyve. E kush prej tyre do ta donte më shumë, thua ti?”

Simoni iu përgjigj: “Ma merr mendja, ai që i kishte borxh më shumë.”

Jezusi i tha: “Ke gjykuar drejt.”

Dhe, duke u kthyer nga gruaja i tha Simonit: “A e shikon këtë grua? Unë hyra në shtëpinë tënde dhe ti nuk më dhe ujë për të larë këmbët; ajo m’i lau me lot dhe m’i thau me flokët e saj. Ti nuk më dhe kurrë një të puthur; kurse ajo qëkurse kam hyrë nuk pushon së puthuri këmbët e mia. Ti nuk me ke vënë pak vaj aromatik as në kokë, kurse ajo më ka spërkatur këmbët. Prandaj po të them: asaj i falen shumë mëkate, sepse ka dashur shumë. Atij që i falin pak, dashuron pak.”

Luca, 7, 37-47

Na ishte njëherë një prostitutë që quhej Maria.

Oh, një minutë. “Na ishte njëherë” është fraza më e përshtatshme për të filluar një histori për fëmijë, ndërsa “prostitutë” është një fjalë për të rritur. E si mund ta shkruaj këtë libër që fillon me një mospërputhje kaq të dukshme? Sidoqoftë, përderisa në çdo moment të jetës sonë një këmbë e kemi në përrallë e tjetrën në humnerë, do të mbaj këtë *hyrje*.

Na ishte njëherë një prostitutë që quhej Maria.

Si të gjitha prostitutat, kishte lindur e virgjër dhe e pafajshme, në adoleshencë kish ëndërruar të takonte njeriun e saj të jetës (të pasur, të bukur, të mençur), të martohej (me vello të bardhë), të kishte dy fëmijë (që kur të rriteshin do të bëheshin me famë) dhe të jetonte në një shtëpi të bukur (me pamje nga deti). Babai i saj ishte shitës ambulant, nëna rrobaqepëse. Në qytezën e saj, të humbur në Brazil, kishte vetëm një kinema, një lokal dhe një bankë të vogël. Prandaj, Maria mezi priste ditën kur princi i saj i kaltër të arrinte befas e t’i fitonte

asaj zemrën – pastaj ajo le të nisej me të për të pushtuar botën mbarë.

E përderisa princi i kaltër nuk kish ardhur ende, ajo nuk mund të bënte tjetër veçse të ëndërronte. U dashurua për herë të parë njëmbëdhjetë vjeç, ndërsa bënte në këmbë rrugën nga shtëpia për në shkollë. Që ditën e parë të shkollës ajo vuri re se nuk ishte e vetme që e bënte atë rrugë: përbri saj ecte një djalosh që jetonte jo larg shtëpisë së saj dhe kishte të njëjtin orar mësimesh. Ata të dy nuk shkëmbyen kurrë një fjalë, megjithatë Maria filloi ta kuptonte se momenti më i bukur i ditës për të ishte kur rendte rrugës me pluhur, e etur, e lodhur e me diellin që i binte në majë të kokës, pas atij djaloshi këmbëshpejtë, tek përpiquej me të gjitha forcat të ecte në një hap me të.

Kjo skenë do të përsëritej për muaj të tërë. Maria, që e urrente studimin e nuk shikonte argëtim tjetër përveç televizionit, ato kohë, vetëm priste të kalonte dita shpejt: i rrinte mendja gjithë ankth tek dita tjetër e shkollës dhe, ndryshe nga shoqet e tjera, gjënë më të mërzitshme kishte fundjavën. Dhe, për një fëmië, orët kalojnë shumë më ngadalë sesa për një të rritur, kështu ajo vuante shumë: qahej për ditët kaq të gjata që i linin vetëm nga dhjetë minuta dashurisë së saj të jetës dhe miëra orë të tjera në të cilat ajo mendonte vetëm për atë, duke hamendësuar se sa bukur do të ishte sikur të flisnin bashkë.

Dhe kjo ndodhi një ditë.

Një mëngjes, djali iu afrua, i kërkoi hua një penë. Maria nuk iu përgjigj, mori një çehre të ngrysur prej këtij

afrimi të papritur dhe shpejtoi hapin. Ishte ngurtësuar e gjitha nga frika kur e kish vënë re të afrohej në drejtim të saj; terrorizohej kur mendonte se ai do ta kuptonte sa shumë e donte ajo, sa shumë po e priste, si ëndërronte ta kapte për dore, të kapërcente me të rrethimin e shkollës dhe të vazhdonin deri në fund të rrugës, ku – siç thuhej – dukej një qytet i madh, me personazhe fantastikë, artistë, makina, shumë kinema dhe një pafundësi gjërash të bukura që mund të realizoheshin.

Atë ditë nuk arriti të përqendrohej aspak në mësim. Vuante për sjelljen e saj absurde, por nga ana tjetër ndihej pak e lehtësuar se e kuptoi që edhe djaloshi e kishte vënë re. Pena ishte vetëm një shkak për t'i folur, sepse Maria, kur ai i qe afruar, pa që ai e kishte në xhep një penë. Filloi të priste bisedën tjetër dhe e kaloi atë natë – sikurse të tjerat që do të pasonin – duke fantazuar përgjigjet e mundshme që do t'i jepte, derisa të gjente mënyrën e duhur për të filluar një marrëdhënie që nuk do të kishte kurrë mbarim.

Por, bisedë tjetër nuk pati më. Për sa kohë vazhduan të shkonin bashkë në shkollë – nganjëherë Maria i dilte ndonjë hap përpara duke mbajtur në dorë një penë, herë i rrinte pas për ta parë me ëmbëlsi – nuk i hodhi më kurrë ndonjë fjalë, e asaj i mbetej t'i gëzohej dashurisë e vuajtjes në heshtje deri në mbarim të vitit shkollor.

Një mëngjes, gjatë pushimeve të stërzgjatura të verës, Maria u zgjua me këmbët e lagura me gjak dhe mendoi se po vdiste. Vendosi t'i shkruante një letër djaloshit që e deshi aq shumë e, më pas, do të hynte thellë në *sertào*,

në atë territor të thatë e të shkretë, që ta gllabëronin bishat e egra të cilët terrorizonin banorët e zonës: ujku i uritur dhe mushka pa kokë. Vetëm kështu prindërit e saj nuk do të vajtonin për të, do ta mbanin gjithmonë gjallë shpresën siç dinë të bëjnë vetëm të varfrit, pavarësisht nga fatkeqësitë që u ndodhin. Mbase do të mendonin se ishte grabitur nga ndonjë familje e pasur pa fëmië dhe se një ditë do të kthehej mbuluar me lavdi e pará; edhe dashurinë e tanishme (e të përhershme) të jetës së saj do ta ruante përgjithnjë, si një vuajtje të përditshme për një fjalë që nuk u tha më kurrë.

Nuk arriti dot ta shkruante atë letër, sepse në dhomë hyri e ëma, pa çarçafin me njolla të kuqe, buzëqeshi dhe tha:

“Tani je një zonjushë, bija ime.”

Maria donte të dinte se ç’lidhje kishte me gjakun që rridhte të qenët zonjushë, por nëna nuk diti t’ia shpjegonte: i tha vetëm se ishte një gjë normale dhe që tani e tutje duhet të përdorte një si jastëkth kukullash midis këmbëve, për katër a pesë ditë në muaj. Kur e pyeti nëse edhe burrat përdornin një tubth për të ndaluar gjakun të dalë mbi pantallona, mësoi se kjo gjë u ndodh vetëm grave.

Maria u ankua te Zoti, por më në fund filloi të mësohej edhe me periodat. Por, me mungesën e djaloshit nuk po mësohej dot, prandaj vazhdonte të hante veten për atë sjellje prej budallajeje që e kish larguar nga ajo çka dëshironte më shumë. Ditën kur do të rifillonte shkolla,

shkoi në kishën e vetme të qytezës dhe u betua përpara statujës së Shën Ndoit se do ta merrte vetë iniciativën për të folur me shokun e saj të udhës.

Të nesërmen u përgatit gjithë kujdes, veshi fustanin e ri që nëna ia kish qepur për fillimin e shkollës; pastaj doli, duke lavdëruar Zotin që pushimet kishin marrë fund. Por djaloshi nuk u duk. Kaloi një javë të tërë në ankth, derisa mësoi nga disa shokë, se ai ishte shpërngulur në një qytet tjetër.

“Ka ikur larg”, kish thënë dikush.

Atë çast, Maria mësoi se ka gjëra që i humbasim përgjithmonë. Kuptoi se ka një vend të quajtur “larg”, se bota është e madhe ndërsa qyteza e saj e vogël dhe se njerëzit më të rëndësishëm ikin që aty. Edhe ajo do të donte të ikte, por ishte ende shumë e re. Duke vërejtur rrugët me pluhur të vendbanimit të saj, një ditë vendosi të ndiqte përsëri gjurmët e atij djaloshit. Në nëntë të premtet që pasuan, sipas një zakoni të besimit të saj, i kërkoi Virgjëreshës Mari, që një ditë ta çonte larg atij vendi.

Për ca kohë vuajti, duke kërkuar më kot lajme për djaloshin, askush nuk e dinte se ku ishin shpërngulur prindërit e tij. Maria filloi pastaj të mendonte se bota ishte tepër e madhe e dashuria shumë e rrezikshme, se Virgjëresha jetonte shumë larg në qiell dhe nuk kujdesej të plotësonte kërkesat e fëmijëve.

Do të kalonin tre vjet. Maria mësoi gjeografinë dhe matematikën, ndiqte intrigat e telenovelave, në shkollë lexoi revistat e para erotike dhe filloi të mbajë një ditar në të cilin shkruante për jetën e saj monotone dhe dëshirën për të njohur ato çka i mësonin në shkollë – oqeanin, borën, burrat me çallmë, gratë elegante e të mbuluara me stoli. Por, përderisa askush nuk mund ta shtyjë jetën me dëshira të papërmbushura – sidomos kur ke nënën rrobaqepëse dhe një baba gjithmonë rrugëve – shpejt kuptoi se duhet të tregonte më shumë kujdes për atë që ndodhte përreth saj. Studionte që t’ia dilte në jetë e, ndërkohë, kërkonte dikë me të cilin të ndante ëndrrat e saj aventurore. Kur mbushi pesëmbëdhjetë vjeç, u dashurua me një djalë që e njohu gjatë një procesioni të Javës së Shenjtë.

Nuk e përsëriti gabimin e fëmijërisë: bisedoi me të, u bënë miq, filluan të shkojnë bashkë në kinema dhe nëpër festa. Ajo vuri re se, sikurse i kish ndodhur edhe me djaloshin, dashuria kishte të bënte më shumë me mungesën, sesa me praninë e tjetrit: vuante kur ai nuk ishte, i kalonte orët duke përfytyruar se çfarë do të

bisedonin takimin tjetër dhe kujtonte çdo sekondë që kish kaluar me të, duke u sforcurar të merrte vesh se çfarë kishte bërë mirë e çfarë keq. Tanimë ishte e vendosur të luftonte me të gjitha forcat e saj për këtë shok, për martesën me të: po, sepse ishte pikërisht ai, burri me të cilin donte të martohej, të kishte fëmië dhe një shtëpi me pamje nga deti. Foli edhe me nënën, por kjo i tha me ton lutës:

“Është ende shumë shpejt bija ime.”

“Po ti je martuar me babanë gjashtëmbëdhjetë vjeçe.”

Nëna nuk donte t’i thoshte se kishte ndodhur si pasojë e një shtatzënie të papritur, prandaj e mbylli këtë temë me frazën klasike: “Kohët kanë ndryshuar.”

Të nesërmen dy të rinjtë shkuan të bëjnë një shëtitje në rrethinat e qytezës. Në bisedë e sipër, Maria e pyeti djalin nëse kishte dëshirë të udhëtonte; ai, në vend të përgjigjes e shtrëngoi në krahët e tij dhe i dha një të puthur.

Puthja e parë e jetës së saj! Sa e kishte ëndërruar atë çast! Dhe peizazhi ishte me të vërtetë i veçantë: çafkat në fluturim, perëndimi, bukuria e ashpër e atij terreni gjysmë të thatë dhe së largu dëgjohej një muzikë. Maria bëri sikur reagoi, sikur do ta kundërshtonte, por pas një çasti e përqafoi edhe ajo dhe përsëriti atë gjest që e kish parë aq herë në kinema, nëpër revista dhe në televizion: i ngjiti me forcë buzët e veta me të tijat, duke e lëvizur kokën sa në një krah në tjetrin, me një mënyrë ritmike, pothuajse të pakontrolluar. Ndjeu që, herë pas here, gjuha e djaloshit i prekte dhëmbët dhe kjo i shkaktonte një ndjesi të mrekullueshme.

Por befas ai e ndërpreu të puthurën.

“Nuk do?” , e pyeti.

Si t’i përgjigjej? Që donte? Patjetër që donte! Por një grua nuk duhet të bjerë aq poshtë, sidomos me burrin e saj të ardhshëm, sepse gjatë gjithë jetës atij do t’i mbetej dyshimi se ajo i kishte pranuar me shumë lehtësi. Preferoi të mos thoshte asgjë.

Djaloshi e përqafoi përsëri, duke e përsëritur gjestin, kësaj radhe me më pak dëshirë. Më pas ndaloi përsëri, i nxirë i tëri – dhe Maria e kuptoi se diçka nuk shkonte, por i vinte turp ta pyeste. E kapi për dore dhe ecën së bashku deri në hyrje të qytezës, duke u fjalosur, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Atë mbrëmje duke i zgjedhur me kujdes fjalët me mendimin që një ditë gjithë sa shkruante tani do të lexohej, e sigurt se kish ndodhur një gjë shumë e rëndësishme, shënoi në ditar:

Kur takojmë dikë dhe dashurohemi, na duket sikur gjithë universi është në harmoni. Kjo ndodhi sot në perëndim. Por nëse diçka nuk shkon mirë, asgjë nuk mbetet! As çafkat, as muzika e largët, as shija e buzëve të tij. E si mund të zhduket kaq shpejt bukuria që mbretëronte pak minuta më parë?

Jeta rrjedh shumë shpejt: të hedh nga parajsja në ferr brenda pak sekondave.

Të nesërmen u tregoi shoqeve. Të gjitha e kishin parë tek largohej jashtë qytezës me “të fejuarin” e saj të

ardhshëm – dhe në fund të fundit, nuk mjafton të ndjesh një dashuri të madhe, duhet t’ua rrëfesh atë edhe të tjerëve. Ato ishin kurioze të dinin se çfarë kishte ngjarë e, Maria, krenare, tha se momenti më i bukur ishte ai i gjuhës që i prekte dhëmbët. Njëra nga vajzat qeshi.

“Nuk e hape gojën?”

Tani e mori vesh menjëherë: pyetja pastaj zhgënjimi.

“Përse?”

“Që të hynte brenda gjuha.”

“E ku është dallimi?”

“Është e pamundur ta shpjegosh. Kështu puthet dhe pikë.”

Të qeshura të mbajtura me zor, shprehje false, hakmarrje vajzash që nuk kishin pasur ende një të dashur. Maria bëri sikur nuk iu dha rëndësi; qeshi edhe ajo – megjithëse shpirti i saj po i vajtonte. Mallkoi me vete kinemanë që e kishte mësuar të mbyllte sytë, të mbante kokën e partnerit me duar dhe ta lëvizte fytyrën sa nga njëra anë në tjetrën, por pa treguar atë që ishte më kryesore. Përpunoi në mendje një shpjegim bindës (“Nuk desha të jepesha menjëherë, sepse nuk isha e bindur, por tani e kam kuptuar që ti je njeriu i jetës sime”) dhe priti rastin tjetër.

Djalin e pa vetëm pas tri ditësh, në një festë në sheshin e qytezës, kishte kapur për dore një shoqen e saj – pikërisht atë që e kishte pyetur për puthjen. Edhe këtë radhë Maria bëri sikur nuk i dha rëndësi kësaj skene

dhe rezistoi aty deri në fund të mbrëmjes, duke biseduar me shoqet e aktorëve dhe djemve të tjerë vendas e, duke injoruar edhe vështrimet plot dhembshuri që i hidhte njëra prej tyre. Kur u kthye në shtëpi, nuk u përmbajt më, qau gjithë natën. Vuajti për tetë muaj dhe, në fund i dha karar, dashuria nuk ishte për të e as ajo nuk ishte për dashurinë. Që nga ai çast filloi të mendonte se si mund të bëhej murgeshë, t'ia përkushtonte jetën e saj këndeje e tutje një lloj dashurie që nuk plagos e nuk lë plagë të dhimbshme në zemër: dashurisë për Jezusin. Në shkollë flitej për misionarë që shkonin në Afrikë e, kështu, ajo vendosi se kjo do të ishte zgjidhja më e mirë për jetën e saj të zhveshur nga emocionet. Bëri plan të hynte në kuvend, mësoi nocionet bazë të ndërhyrjes së shpejtë (disa mësues thoshin se në Afrikë vdisnin shumë njerëz), filloi të merrej shumë me leksionet e fesë dhe nisi ta imagjinonte veten si një shenjtoreshë e kohëve moderne, që shpëtonte jetë njerëzish dhe eksploronte pyje të banuara nga tigra e luanë.

Viti i ditëlindjes së saj të pesëmbëdhjetë, megjithatë, nuk i rezervoi vetëm zbulimin se e puthura bëhej me gojë hapur, apo se dashuria është burim vuajtjeje. Zbuloi edhe një gjë të tretë: masturbimin. Kjo ndodhi krejt rastësisht, ndërsa po luante me seksin e vet duke pritur të vinte e ëma. E kishte provuar këtë gjë që fëmië si ndjesi shumë të këndshme – por një ditë babai e kishte parë dhe e

kishte rrahur, pa i dhënë shpjegime. Maria nuk i harroi kurrë ato shpulla, mësoi se nuk mund ta prekte seksin e vet përpara të tjerëve. Që nga ajo ditë, përderisa këtë nuk mund ta bënte rrugëve e në shtëpi nuk kishte dhomë të sajën, e harroi fare atë ndjesi të këndshme.

Kështu deri atë pasdite, plot gjashtë muaj nga e famshmja puthje e parë. Babai sapo kish dalë me një mik, nëna vinte vonë e ajo nuk kishte me ç'të merrej; në mungesë të ndonjë programi interesant në televizor, filloi të këqyrte trupin e vet për të gjetur ndonjë qime të padëshiruar që ta shkulte me pincetë. U befasua, tek vuri re një “lajthizë” në pjesën e sipërme të seksit: filloi të luante me të dhe... Pastaj nuk po dinte të ndalej. I sillte gjithmonë e më tepër kënaqësi, akoma më tepër dhe, pastaj i gjithë trupi – po sidomos pjesa që po prekte – zu t’i mpihej. Pak e nga pak, po ndiente sikur po i hapeshin portat e parajsës; ndjesia po bëhej gjithmonë e më e fortë dhe, ajo po kuptonte që tanimë nuk arrinte as të shikonte e as të dëgjonte më, sikur gjithçka ishte bërë e verdhë, derisa filloi të rënkojë nga kënaqësia e orgazmës së parë.

Orgazma! Qejfi!

I qe dukur sikur, pasi ishte ngritur lart në qiell, po zbriste pastaj me parashutë, ngadalë drejt tokës. Trupi i ishte qullur në djersë, por ajo ndihej e pëmbushur, e realizuar, gjithë energji. Ky na qenka seksi, atëherë! Çfarë mrekullie! Ku e ku revistat pornografike, aty të gjithë flasin për kënaqësi, por kanë një pamje të përvuajtur. Pa pasur edhe nevojë fare për burrat, që ia duan trupin,

por ia përcmojnë zemrën gruas! Mund ta bënte gjithçka vetë! Ia nisi edhe një herë nga e para, duke përfytyruar sikur e përkëdhelte një aktor me famë dhe përsëri shkoi në parajsë, për të zbritur pastaj me parashutë e mbushur plot energji. Ndërsa bëhej gati të masturbonte për të tretën herë, erdhi e ëma.

Maria foli me shoqet për zbulimin e ri, duke mos thënë sigurisht që ajo sapo e kishte eksperimentuar vetëm disa orë më parë. Të gjitha, përveç nja dy vajzave, e dinin për çfarë bëhej fjalë, por asnjëra nuk kish pasur kurajon të fliste hapur. Pikërisht në atë çast, Maria u ndie një revolucionare, udhëheqëse e grupit dhe, duke shpikur kot “lojën e rrëfimeve sekrete”, i kërkoi gjithsecilës të tregonte mënyrën e preferuar të masturbimit. Kështu mësoi shumë teknika të ndryshme, se si mund të rrihej nën një batanije mu në mes të verës (sepse, siç thoshte njëra prej vajzave, djersa i lehtësonte lëvizjet), si mund të përdorej një pendë rose për të prekur “lajthizën” (ajo nuk e dinte si quhej), si mund të lihej një djalë ta bënte këtë gjë (kjo Maria e dukej krejt e paimagjinueshme), si mund të përdorej bideja për këtë punë (ajo nuk e kishte në shtëpi, por sapo të shkonte në shtëpinë e ndonjë shoqeje, do ta provonte menjëherë).

Gjithsesi, pasi zbuloi masturbimin dhe teknikat që i sugjeruan shoqet e saj, hoqi dorë përgjithmonë nga jeta prej besimtareje. E, ndërsa jepte një kënaqësi kaq të madhe; përkundrazi, në kishë, seksi quhej si mëkati më i rëndë nga gjithë të tjerët. Po nga disa shoqe, u vu në

dijeni të disa thënieve: masturbimi ta mbush fytyrën me puçrra, të çon në çmendi ose në shtatzëni. Prandaj nga frika e këtyre rreziqeve, filloi të provokonte kënaqësi të paktën një herë në javë, përgjithësisht të mërkurave, kur babai dilte të luante letra me shokët.

Ndërkohë, Maria po ndihej gjithmonë e më e pasigurt në marrëdhëniet e saj me burrat – e më shumë i rritej dëshira për të ikur larg vendit ku jetonte. U dashurua për të tretën herë, pastaj për të katërtën: tanimë dinte të puthte e të përkëdhelte dhe i pranonte me qejf të prekurat nga i dashuri. Tek e fundit, kishte gjithmonë një gjë që nuk shkonte si duhet dhe raporti mbaronte pikërisht në momentin kur ajo bindej se ky na qenkësh personi i duhur për të kaluar me të jetën. Prandaj mbërriti në përfundimin se burrat sillnin vetëm dhimbje, mundime e vuajtje, sa më shumë kalonte koha. Një pasdite, ndërsa vërente një nënë tek luante me fëmijën e saj dy vjeç, mendoi se mund ta rishikonte idenë për të pasur një burrë, fëmijë dhe një shtëpi me pamje nga deti, por nuk do të dashuronte më kurrë, sepse pasioni shkatërronte gjithçka.

*K*ështu kaluan vitet e adoleshencës për Marien. Ajo bëhej gjithmonë e më e bukur; kishte një pamje misterioze dhe të trishtuar dhe shumë burra i binin pas. Shkoi me njërin, pastaj me një tjetër, ëndërroi, vuajti, edhe pse kish vendosur se nuk do të dashuronte me kurrë. Në njërën nga këto marrëdhënie humbi virgjërinë, në sediljen e pasme të një makine. Maria dhe i dashuri i saj po përkëdheleshin më me afsh se herët e tjera; djali u eksitua tej mase dhe ajo, e lodhur së qeni virgjëresha e fundit e grupit, e la të depërtonte. Krejt ndryshe nga masturbimi që e çonte lart në qiell, ai akt i la vetëm dhimbje, një rrjedhë gjaku që i la një njollë në fund, të cilën mezi e lau më vonë. Jo, nuk provoi atë ndjesinë magjike të puthjes së parë: me çafkat në fluturim, perëndimin, muzikën... Jo, as që donte ta sillte ndër mend.

Bëri dashuri edhe herë të tjera me atë djalë, duke e kërcënuar se po ta merrte vesh i ati që ai e kish dhunuar, mund edhe ta vriste fare. Ai u bë kështu një instrument matës që ajo e përdorte në tentativën e saj kryeneçe për të kuptuar se ku ishte kënaqësia e seksit me një partner.

Nuk e kuptoi kurrë. Masturbimi bëhej më lehtë dhe i jepte shumë më tepër. Por, gjithçka, revistat, programet në televizor, librat, shoqet, gjithçka, ABSOLUTISHT GJITHÇKA, i fliste për rëndësinë e një burri. Maria filloi të mendonte se mos kishte ndonjë problem seksual të parrëfyeshëm, u përqendrua më shumë në studimet dhe, për disa kohë, e harroi atë gjë të mrekullueshme dhe vrastare që quhej “Dashuri”.

Nga ditari i Maries, kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeç:

Objektivi im është të kuptoj dashurinë. E di që isha e gjallë kur dashuroja, e di, gjithashtu, se gjithçka që kam tani, edhe pse mund të duket interesante, mua as që më hyn në sy.

Por dashuria është e tmerrshme: Kam parë disa shoqe të mia të vuajnë e nuk dua të katandisem si ato. Ato që qeshnin dikur me pafajësinë time tani habiten me mua se si arrij t'i zotëroj kaq mirë burrat. Unë buzëqesh dhe hesht, sepse e di, ilaçi në këtë rast është më i keq edhe se dhimbja vetë: thjesht nuk dashuroj. Çdo ditë që kalon, shikoj më qartë sesi burrat janë të brishtë, të paqëndrueshëm, të pasigurt, të hutuar... Babai i njëjës prej shoqeve m'i ka hedhur ca fjalë, po unë e kam refuzuar. Më parë isha e shokuar, kurse tani e di se kjo është pjesë e natyrës së mashkullit.

Sado që objektivi im është të kuptoj dashurinë, sado që kam vuajtur prej njerëzve që kanë hyrë në zemrën time, vërej se ata që kanë prekur shpirtin tim nuk ia kanë arritur të më zgjojnë trupin, ndërsa ata që më kanë përkëdhelur trupin, nuk kanë qenë në gjendje të mbërrijnë deri në shpirtin tim.

*M*aria mbushi nëntëmbëdhjetë vjeç, mbaroi shkollën e mesme, gjeti punë në një dyqan pëlhurash dhe pronari na u dashurua me të. Tanimë, ajo dinte si ta përdorte një burrë pa i lejuar atij të bënte të njëjtën gjë. Nuk e linte kurrë ta prekte, edhe pse tregohej gjithmonë joshëse, e vetëdijshme për pushtetin e bukurisë së saj.

Pushteti i bukurisë: po si do të ishte bota për vajzat e shëmtuara? Njihte disa vajza të cilave askush nuk ua varte nëpër festa, askush nuk i pyeste “Si je?” Mund të duket e pabesueshme, por ishin këto vajza që mbivlerësonin dashurinë false që merrnin dhe, kur braktiseshin, vuanin në heshtje dhe sforcoheshin të përballonin të ardhmen duke mos menduar të zbukuroheshin për dikë tjetër. Ishin më të pavarura, më të përqendruara te vetvetja, sido që në imagjinatën e Maries bota për to duhej të ishte e padurueshme.

Sidoqoftë, ajo ishte krejt e vetëdijshme për bukurinë e saj. I harronte gjithmonë këshillat e nënës, por njërën nuk e hiqte kurrë nga mendja: “Bija ime, bukuria nuk

zgjat shumë.” Pikërisht për këtë mbante një raport të rezervuar me punëdhënësin e saj – as i afërt e as i largët – e si rrjedhojë rroga e saj po shtohet gjithmonë e më shumë (nuk e dinte se deri kur do të mund ta ushqente tek ai shpresën se një ditë do të binte në shtrat me të, por ndërkaq fitonte mirë), pa llogaritur pagesën e orëve jashtë orarit (tek e fundit ai donte ta kishte gjithmonë pranë, sepse mbase duke dalë mbrëmjeve kishte frikë se mos ajo takonte dashurinë e vërtetë). Punoi për njëzet e katër muaj pa bërë pushime, u dha prindërve çdo muaj nga një sasi parash dhe... më në fund ia doli mbanë! Bëri paratë që duheshin për të kaluar një javë pushime në qytetin e ëndrrave të saj, në qytetin e artistëve, kartolina e vendit të saj: Rio-de-Zhanejro!

Pronari i dyqanit që gati ta shoqëronte duke paguar të gjitha shpenzimet, por Maria, me një gënjeshtër, e shmangu këtë ofertë, duke thënë se nëna i kishte vënë një kusht, të flinte në shtëpinë e një kushëriri që praktikonte *ju-jitsu*, pasi Rio ishte një ndër qytetet më të rrezikshme të botës.

“Pastaj”, vazhdoi ajo, “ju nuk mund ta lini dyqanin pa një njeri të besuar.”

“Mos më fol me “ju”, tha burri dhe Maria pa në sytë e tij diçka që e njihte mirë: zjarrin e pasionit. Mbeti e befasuar, sepse mendonte që atij i interesonte vetëm seksi. Shikimi i tij, në të vërtetë, dëshmonte të kundërtën: “Mund të të jap një shtëpi e një familje dhe para për prindërit e tu.” Duke menduar për të ardhmen vendosi ta ushqente atë zjarr.

I tha se do ta ndiente shumë mungesën e punës që e donte, e njerëzve me të cilët kishte qejf të rrinte (nuk përmendi askënd në veçanti, duke e lënë të pazbuluar misterin: shprehja “njerëzit” i referohej atij?) dhe i premtoi se do të ishte shumë e kujdesshme për veten dhe portofolin. E vërteta ishte tjetër: ajo nuk donte që askush, absolutisht askush, t’ia prishte javën e saj të parë të lirisë totale. Kishte qëllim të shijonte gjithçka: të lahej në det, të fjalosej me të huajt, të kundronte vitrinat e dyqaneve, të ishte e gatshme ndaj ndonjë princi të kaltër që do të mund ta rrëmbente përgjithnjë.

“Po çfarë është një javë, në fund të fundit?” tha me një buzëqeshje të hidhur, por pa e fshehur shpresën. “Kalon shpejt, e shpejt vjen kthimi, me gjërat e përditshme për t’i përballuar, si gjithmonë.”

Pronari i dyqanit, qejfprishur, kërkoi ta kundërshtonte, por më në fund pranoi, se nuk donte të shkatërronte gjithçka, sidomos kur mendonte në fshehtësi që, sapo ajo të kthehej, t’i kërkonte dorën për martesë.

Maria udhëtoi për dy ditë me traget, gjeti strehë në një hotel të kategorisë së pestë në Kopakabana (Ah, Kopakabana! Plazhi, qielli...) dhe, ende pa zbratur valixhet, mori një kostum banje që sapo e kish blerë, e veshi, e shkoi në plazh pavarësisht se qielli ishte me re. Shikoi detin dhe u frikësua; më në fund hyri në ujë, gjithë turp.

E kush e dinte në plazh se ajo vajzë takonte për herë të parë oqeanin, perëndesha *Jemanjà*, rrymat e detit, shkuma e valëve, e më përtej Atlantikut, bregu i Afrikës me luanët e saj. Kur doli nga uji i afrohet një grua që donte t'i shiste sandwich biologjik, pastaj një zezak bukurosh që e pyeti në ishte e lirë për atë mbrëmje dhe nga një tip tjetër që nuk shkrapte një fjalë në portugalisht, por që me gjeste e ftonte të pinte një qumësht kokosi.

Maria bleu një panine se i vinte turp t'i thoshte jo shitëses, por nuk u foli dy të panjohurve të tjerë. Befas u trishtua: tek e fundit, tani që mund të bënte atë që donte, përse sillej në mënyrë kaq të rezervuar? Në mungesë të një shpjegimi të vlefshëm, u ul dhe priti që dielli të dilte nga retë, e befasuar nga kurajoja e saj dhe temperatura e ujit, kaq e ftohtë në pikë të verës.

Ndërkohë, njeriu që nuk dinte portugalisht i doli përpara me një kokos dhe ia ofroi. E kënaqur që nuk ishte e shtrënguar të fliste, Maria piu qumështin e kokosit dhe buzëqeshi, edhe ai ia ktheu buzëqeshjen. Për ca kohë, bënë një si bisedë që nuk thoshte asgjë – ndonjë buzëqeshje herë pas here - derisa burri nxori nga xhepi një fjalorth me kopertinë të kuqe dhe me një theks të çuditshëm, tha: “*Bonita*, bukuroshe.” Maria qeshi përsëri. Sigurisht, do t'i pëlqente të takonte princin e kaltër, por ky duhet të fliste gjuhën e saj dhe duhet të ishte më i ri.

Burri këmbënguli duke shfletuar libërthin:

“Darkë, sot?” Dhe shtoi menjëherë: “*Zvicra!*”, duke e plotësuar bisedën me fjalë që tingëllonin si kambanat

e parajsës në çdo gjuhë që të shqiptoheshin: “Punë! Dollarë!”

Maria nuk e dinte restorantin “Zvicra”. A ishte e mundur që gjërat të ishin kaq të lehta dhe ëndrrat të realizoheshin kaq shpejt? Më mirë të mos i zinte besë. “Faleminderit për ftesën, por jam e zënë. E nuk më intereson fare të blej dollarë.”

Burri, që nuk kuptoi asnjë fjalë të përgjigjes, filloi të shqetësohej. Pas disa buzëqeshjesh nga të dyja palët, u largua për një minutë duke u kthyer me një përkthyes. Me të, i shpjegoi se vinte nga Zvicra – pra, nuk ishte restorant: ishte një vend – dhe e ftonte të hante darkë me të, sepse kishte një punë për t’i ofruar. Përkthyesi që u prezantua si asistent i të huajit, rojë në hotelin ku rrinte i huaji, shtoi nga vetvetja:

“Po të isha në vendin tënd do të pranoja. Ky burrë është një sipërmarrës i rëndësishëm dhe ka ardhur këtu të zbulojë talente të reja që mund të punojnë në Evropë. Nëse dëshiron, do t’ju tregoj disa gra që kanë pranuar ofertën e tij: janë bërë të pasura e tani janë martuar e kanë fëmijë që, sigurisht, nuk kanë përse të mendojnë si e si të vjedhin apo të bredhin rrugëve pa punë si të tjerët.” E duke dashur t’i bënte përshtypje me kulturën e tij ndërkombëtare, tha në fund: “Veç të tjerash, në Zvicër bëjnë çokollata të shijshme dhe orë të përsosura.”

E vetmja përvojë artistike e Maries ishte interpretimi i një shitëseje uji – që hyn në heshtje dhe del pa thënë asnjë fjalë – gjatë shfaqjes Pasioni i Krishtit që organizohej çdo

vit nga autoritetet e qytezës së saj në Javën e Shenjtë. Gjatë udhëtimit në traget nuk kishte fjetur dot, se e kishte zënë deti, ishte e lodhur së ngrëni panine, herë biologjike, herë normale, ishte e hutuar, sepse nuk njihnte asnjëri e donte të takonte një mik sa më shpejt. Situata si kjo, kur një burrë premtonte gjithçka dhe nuk bënte asgjë, kishte hasur edhe herë të tjera dhe e kuptonte që historia e sipërmarrësit ishte një sajesë për ta tërhequr në diçka, të cilën ajo nuk ishte e sigurt se nuk e dëshironte.

Por, e bindur se ishte Virgjëresha që ia ofronte atë rast, e vendosur se duhej përfituar nga çdo sekondë e ditëve të pushimeve e duke thënë me vete se të paktën të kishte diçka për të treguar kur të kthehej, vendosi ta pranonte ftesën – me kusht që ta shoqëronte edhe përkthyesi, sepse po lodhej së qeshuri pa kuptuar asgjë nga ato që thoshte i huaji.

Kishte vetëm një pengesë dhe të rëndë: nuk kishte asnjë fustan të përshtatshëm për një rast si ky. Një grua nuk do t'i rrëfente kurrë mendime intime si këto (më mirë ta tradhtojë burri, sesa të tregojë gjendjen e garderrobës së saj), por përderisa nuk i njihnte ata burra dhe mbase nuk do t'i takonte më kurrë, tha me vete se nuk kish ç'të humbiste.

“Sapo kam ardhur nga Verilindja e nuk kam asgjë të hajrit për të veshur në një darkë në restorant.”

Përmes përkthyesit, burri i tha se nuk kishte përse shqetësohej dhe i kërkoi adresën e hotelit të saj. Atë

pasdite, asaj i erdhi një fustan shumë i bukur – që s’e kish parë kurrë në jetën e saj - shoqëruar me një palë këpucë që duhej të kishin kushtuar aq sa ajo fitonte në vit.

Maria e ndjeu se aty fillonte udha që e kish dëshiruar aq shumë në fëmiërinë dhe adoleshencën e vet në *sertão*-n braziliane, në atë territor pa ujë me të rinj pa të ardhme, në atë qytezë të ndershme dhe të varfër, duke shtyrë ditët si njëra-tjetrën pa pikë interesi: tani i bëhej se po shndërrohej në princeshën e universit! Një burrë i kishte ofruar punë dhe dollarë, një palë këpucë të shtrenjta dhe një fustan si i një mië e një netëve! I mungonin mjetet e makijazhit, por nëpunësja e hotelit, për solidaritet femëror, i vjen në ndihmë, pa harruar ta paralajmërojë se jo të gjithë të huajt janë njerëz të mirë e jo të gjithë banorët e Rios janë hajdutë.

Maria as që e mori për bazë paralajmërimin. Veshi atë fustan të mrekullueshëm dhe ndenji gjatë përpara pasqyrës duke u penduar se si nuk kish marrë me vete një aparat fotografik për ta fiksuar atë çast; mbeti aty derisa u kujtua se po bëhej vonë për takimin. Doli duke vrapuar, njësoj si Hirushja dhe mbërriti në hotelin ku rrinte zvicerani.

Për habinë e saj, përkthyesi i tha menjëherë që ai nuk do t’i shoqëronte:

“Mos e vrit mendjen për gjuhën. E rëndësishme është që ai të ndihet mirë në shoqërinë tënde.”

“E si do të jetë e mundur kjo, nëse nuk do të kuptojë fjalët e mia?”

“Është më mirë kështu. Nuk ka nevojë për fjalë: është një çështje energjie.”

Maria nuk e kuptonte domethënien e shprehjes “një çështje energjie”. Në vendin e saj njerëzit kishin nevojë të këmbenin dy fjalë, fraza, të bënin pyetje e të jepnin përgjigje sa herë që takoheshin. Por Mailson – kështu quhej përkthyesi/roja trupore – e siguroi që në Rio-de-Zhanejro dhe, kudo në botë, gjërat ishin ndryshe.

“Nuk ka nevojë të kuptojë asgjë, bëje vetëm të ndihet rehat. Ky burrë është një i ve pa fëmië, pronar i një diskoteke dhe po kërkon vajza braziliane që duan të punojnë jashtë shtetit. I thashë që ti nuk je tamam tipi që kërkon ai, por këmbënguli, duke më shpjeguar se është dashuruar me ty sapo të pa të dilje nga uji. I është dukur i bukur edhe kostumi yt i banjës.”

Pushoi pak.

“Sinqerisht, nëse ke ndër mend të gjesh një të fejuar në Rio, duhet ta ndërrosh menjëherë modelin e kostumit të banjës. Përveç zviceranit, them se nuk ka tjetër në botë që do ta pëlqente kostumin tënd: është krejt jashtë mode.”

Maria bëri sikur nuk e dëgjo. Mailson vazhdoi:

“Sipas meje, ai nuk do thjesht të ketë një aventurë. Mendon se ju keni një talent të mjaftueshëm për t’u bërë vajza më tërheqëse e diskotekë së tij. Qartë, nuk ju ka parë të këndonit a të kërcëni, po këto gjëra mësohen, bukuria është e lindur. Evropianët janë gatuar kështu: mbërrijnë këtu dhe mendojnë se të gjitha brazilianet janë sensuale dhe dinë të vallëzojnë *samba*. Nëse ai burrë ka

qëllime serioze, të këshilloj t'i kërkosh një kontratë – dhe me firmën e saktë të konsullatës zvicerane – përpara se të nisesh. Nesër në mëngjes do të jem në plazh, përpara hotelit. Nëse ke ndonjë dyshim më kërkko.”

Pastaj, duke buzëqeshur, zvicerani e kapi për krahu dhe i tregoi një taksi që e priste.

“Nëse ai e ka mendjen në tjetër vend e ju pranoni, ta dish se tarifa e zakonshme për një natë është treqind dollarë. Për më pak mos prano.”

Vajza nuk arriti të përgjigjej, po i drejtohej restorantit me burrin që përpiqej të shqiptonte ndonjë fjalë. Një bisedë krejt e thjeshtë:

“Të punosh? Dollarë? Yll brazilian?”

Por, ndërkaq, Maria mendonte ende komentet e përkthyesit/rojës trupore: treqind dollarë për një natë! Një pasuri e tërë! Nuk ishte aspak nevoja të vuante nga dashuria; mund ta bënte për vete si pronarin e dyqanit, të martohej, të kishte fëmië dhe t'u ofronte prindërve një jetë për të qenë. E çfarë kishte për të humbur ajo? Ai ishte i vjetër, mbase pas pak kohësh mund të vdiste e ajo do bëhej e pasur: si përfundim, dukej se zviceranët kishin shumë para e pak gra në vendin e tyre.

Gjatë darkës nuk folën shumë – nga një buzëqeshje herë pas here. Maria filloi ta kuptojë se çfarë ishte ajo, “energja”. Burri i tregoi një album me shumë faqe të shkruara në një gjuhë që ajo nuk e njihnte; aty kishte edhe fotografi grash në kostum banje (pa dyshim shumë më të bukur se ai që kish veshur ajo atë pasdite), prerje

nga gazetat, fletëpalosje në të cilat kuptonte vetëm fjalën “Brazil”, shkruar gabim (si nuk e kishin mësuar në shkollë se shkruhej me “s”). Piu shumë duke pasur frikë se zvicerani i bënte ndonjë propozim (tek e fundit, edhe pse nuk e kishte bërë kurrë në jetën e saj deri tani, nuk ishte e lehtë për të t’i shkelte me këmbë treqind dollarë dhe me pak alkool gjërat shkojnë më lehtë, mbi të gjitha atë nuk e njihte askush). Por burri u soll si kavalier i vërtetë, duke i rregulluar edhe karrigen në monetin kur ajo u ul dhe u ngrit. Në fund, Maria tha se ishte e lodhur dhe donte të kthehej në hotel; pranoi të linte një takim në plazh të nesërmen (i tregoi orën, akrepat, imitoi me krahë valët, shqiptoi fjalën “nesër” shumë ngadalë).

Ai dukej i kënaqur, pa orën (patjeter zvicerane) dhe miratoi.

Maria nuk fjeti mirë. Në ëndërr e gjitha kjo i qe dukur një gjë imagjinare. U zgjua dhe e kuptoi se ishte e vërtetë: ishte aty fustani, mbi karrigen e asaj dhome të thjeshtë, aty ishin edhe këpucët e shtrenjta dhe takimi pas pak në plazh.

Nga ditari i Maries, ditën kur njohu zviceranin:

Gjithçka më kumton se po marr një vendim të gabuar, por edhe gabimi është një mënyrë veprimi. E çfarë do bota prej meje? Që të kthehem andej nga erdha? Që të mos i përballoj rreziqet e mia? Të kthehem prapa pa i thënë po jetës?

Veprua gabim kur isha njëmbëdhjetë vjeç e një djalë më kërkoi hua një penë. Që atëherë e kam kuptuar se jo gjithmonë të paraqitet një rast i dytë: duhet pranuar ajo çka bota na ofron. E qartë, është e rrezikshme, po a është ky rrezik më i madh se ai i një aksidenti në të cilin mund të ishte mbytur anija që më solli këtu për dyzet e tetë orë? Nëse duhet të jem besnike ndaj dikujt ose ndaj ndonjë gjëje, më përpara duhet të jem besnike ndaj vetes. Nëse dua të gjej dashurinë e vërtetë, më parë duhet të harroj dashuritë mediokre që kam ndeshur deri tani. Përvoja ime e paktë e jetës më ka mësuar se askush nuk është padron i asgjëje, që gjithçka është një iluzion – si të mirat materiale edhe pasuria shpirtërore. Kush ka humbur diçka që e mendonte të sigurt (mua më ka ndodhur shpesh) arrin të kuptojë që atij nuk i përket asgjë.

Dhe nëse nuk më përket asgjë, atëherë nuk duhet kurrsesi ta humbas kohën duke u shqetësuar për gjëra që nuk janë të miat. Më mirë të jetosh sikurse sot të ishte e para (ose e fundit) ditë e jetës.

*T*ë nesërmen, shoqëruar nga Mailsoni, përkthyes/rojë trupore, që tani bëhej sipërmarrësi i saj, Maria deklaroi se e pranonte ftesën, vetëm se donte t'i lëshohej një dokument firmosur në konsullatën zvicerane. I huaji, që ishte mësuar me këtë tip kërkese, pohoi se kjo ishte edhe dëshira e tij, jo vetëm e saj, sepse për të punuar në Zvicër kërkohesh një dokument zyrtar në të cilin provohej se asnjë person tjetër nuk ishte në gjendje ta kryente punën që propozohej. Nuk ishte e vështirë ta zotëroje këtë dokument, pasi vajzat zvicerane nuk ishin të priruara të vallëzonin *samba*. Vajtën bashkë në qendër; përkthyesi/rojë trupore/sipërmarrës pretendoi një paradhënie në dorë përpara firmosjes së kontratës dhe mbajti për vete tridhjetë për qind të pesëqind dollarëve që mori Maria.

“Ja, kjo është një javë paradhënie. Rroga e një jave, kupton? Do të fitosh pesëqind dollarë në javë dhe pa asnjë ndalesë, sepse interesin ta marr vetëm për pagesën e parë!”

Deri në atë çast, udhëtimet, ideja për të shkuar larg, gjithçka ngjante si një ëndërr për Marien – dhe të ëndërrosh është shumë e lehtë, kur nuk bëjmë atë që kemi projektuar. Kështu nuk rrezikojmë për asgjë, nuk

vuajmë, nuk jetojmë momente të vështira; pastaj, kur plakemi, mund të bëjmë me faj të tjerët, shpesh prindërit, burrat, fëmijët, që nuk na kanë lënë të realizojmë atë që kemi ëndërruar.

Ja ku iu dha rasti që e priste prej kohësh, por nga ana tjetër thellë në vetvete nuk do të donte të mbërrinte kurrë! E si do të mund t'i përballonte sfidat dhe rreziqet e një jete të panjohur? E si mund ta braktiste gjithçka me të cilën ishte mësuar? Përse Virgjëresha kish vendosur të shtynte kaq larg?

Maria u ngushëllua duke menduar se e kishte në dorë vetë të ndërronte mendje në çdo moment, se e gjitha kjo ishte një lojë pa pasoja – diçka interesante për ta treguar kur të kthehej në qytezën e saj. Tek e fundit, jetonte një mijë kilometra larg që aty e tani kishte në kuletë treqind dollarë: nëse të nesërmen do bënte gati valixhet dhe do ia mbathte, askush nuk do e merrte vesh se ku ishte fshehur.

Atë pasdite kur shkuan në konsullatë, Maria vendosi të bënte një shëtitje e vetme në bregun e detit, për të parë fëmijët, të rinjtë që luanin volejball, lypësit, të dehurit, shitësit e prodhimeve tipike artizanale braziliane (prodhuar në Kinë), njerëzit që vraponin e bënin gjimnastikë për të larguar pleqërinë, turistët e huaj, nënat me fëmijët e vegjël, pensionistët që luanin me letra buzë rërës. Kishte ardhur në Rio-de-Zhanejro, kishte ngrënë darkë në një prej restoranteve më luksozë, kishte qenë në

konsullatë, kishte njohur një të huaj dhe një sipërmarrës; i kishin bërë dhuratë një fustan dhe një palë këpucë që askush – po me të vërtetë askush – nuk do t’i blinte dot në qytezën e saj.

Po tani?

Shikoi horizontin: sipas njohurive gjeografike, po të ndiqje vijën drejt, mbërrije në Afrikë, në tokën plot më luanë dhe pyjet me majmunë gorilla. Nëse do të bëje pak për nga veriu do të zbarkoje në atë mbretëri të magjishme që quhet Evropë, atje ku ishte Kulla Eiffel, Disneyland-i i Kontinentit të Vjetër dhe Kulla e pjerrët e Pizës. Nuk kishte se çfarë të humbiste. Si çdo braziliane, kishte mësuar të vallëzonte samba më parë se të shqiptonte fjalën “nënë”. Po të mos i pëlqente do të kthehej përsëri mbrapsht: tanimë e kishte mësuar se fati kapet prej flokësh.

E vendosur të jetonte vetëm ato eksperiencia që arrinte t’i kontrollonte – si, p.sh., aventurat me burrat – shumicën e kohës së saj e kishte shpenzuar duke thënë jo për gjëra që mund të kishte thënë po. Tani gjendej përpara së panjohurës, si eksploratorët e detrave që i kishte njohur në mësimet e historisë. E kishte në dorë të thoshte jo, por në këtë mënyrë, mund ta kalonte gjithë jetën e saj duke u ankuar, siç bënte sot e kësaj dite kur sillte në mend imazhin e djaloshit që njëherë i kishte kërkuar një penë e pastaj që zhdukur bashkë me dashurinë e saj të parë. Edhe më vonë do të kishte rast të thoshte përsëri jo, por tani, këtë herë përse të mos provonte të thoshte po?

Dhe kjo për një arsye mjaft të thjeshtë: ishte një grua e re nga një qytezë e humbur, pa asnjë përvojë jete, që kishte bërë vetëm disa vite shkollë, me një kulturë të gjerë televizive dhe me sigurinë që ishte e bukur. Por, e gjitha kjo ishte krejt e pamjaftueshme për të përballuar botën.

Maria vuri ré një grup njerëzish që qeshnin dhe shikonin detin, sikur të kishin frikë t'i afroreshin. Dy ditë më parë e kishte provuar edhe ajo atë ndjesi; por tani i qe zhdukur: hynte në ujë sa herë të kishte qejf, sikur të kishte lindur aty. A do të mësohej kështu edhe me Evropën?

Recitoi në heshtje një lutje, duke i kërkuar përsëri këshilla Virgjëreshës Maria e, pak sekonda më vonë u ndie e kthjellët në lidhje me vendimin që kishte marrë. Gjthmonë do ta kishte mundësinë të kthehej mbrapsht, por kurrë një rast tjetër për të shkuar kaq larg. Ia vlente barra qiranë ta merrte në sy atë rrezik, nëse kjo ëndërr do t'i rezistonte dyzet e tetë orëve të kthimit me traget pa ajër të kondicionuar e nëse zvicerani nuk do të ndërronte mendje.

Ishte aq entuziaste, saqë kur ai e ftoi për herë të dytë për darkë, mori një pamje sensuale dhe e kapi për dore. Por burri e tërhoqi menjëherë dhe, Maria e kuptoi – me një ndjenjë të përzier frike dhe çlirimi – që evropiani e kishte seriozisht.

“Yll samba!” bërtiti burri pas një copë here. “Ylli i bukur brazilian! Udhëtimi javën tjetër!”

Gjithçka dukej e mrekullueshme, por “Udhëtimi javën tjetër” ishte krejt i pamundshëm. Maria i shpjegoi se nuk mund të merrte një vendim pa u këshilluar edhe me familjen. I zemëruar, zvicerani i tregoi një kopje të dokumentit të firmosur dhe, për herë të parë, ajo pati frikë.

“Kontrata!”, përsëriti ai.

Edhe pse ishte e vendosur të nisej Maria donte të konsultohej me Mailsonin, sipërmarrësin e saj. Në fund të fundit nuk ishte paguar për ta këshilluar?

Mailsoni, tani, dukej i zënë, se donte të bënte për vete një turiste gjermane që, sapo kishte ardhur në hotel e sillej rrotull plazhit me kostum banje topless, e bindur se Brazili ishte vendi më liberal i botës (mbase nuk e kishte vënë re se ishte e vetmja që i kishte gjinjtë zbuluar në të gjithë plazhin dhe se të gjithë e shikonin si të hutuar). Nuk ishte gjë e lehtë të arrinte të tërhiqte vëmendjen e Mailsonit në një situatë si kjo.

“Po qe se më prishet mendja?”, këmbëngulte Maria.

“Nuk e di çfarë është shkruar në kontratë, por mund edhe të të arrestojnë.”

“E ku do më gjejë mua ai!”

“Ke të drejtë. Mos e vrit mendjen.”

Ngaqë kishte investuar tanimë pesëqind dollarë, një palë këpucë, një fustan, dy darka dhe shpenzimet e noterit në konsullatë, ai filloi të humbiste durimin, por duke parë që Maria këmbëngulte që të mund të fliste me familjen, zvicerani vendosi të blinte dy bileta avioni dhe

ta shoqëronte deri në vendlindje; kjo punë duhej zgjidhur në dyzet e tetë orë, që të mund të niseshin javën tjetër, sipas parashikimit. Nga një buzëqeshje në tjetrën, ajo filloi ta kuptonte se e gjitha ishte vendosur në kontratë e nuk kishte vend as për shaka, as për joshje e ndjesi si këto.

Ardhja e vajzës në shoqërinë e një të huaji, ishte një befasi dhe motiv krenarie për qytezën, aq më tepër kur ky do ta çonte drejt Evropës për ta bërë një yll të spektaklit. E morën vesh të gjithë komshinjtë e Maries; shoqet e shkollës e pyesnin:

“Po si është e mundur?”

“Kam pasur fat.”

Donin të dinin nëse gjëra të tilla ndodhnin gjithmonë në Rio-de-Zhanejro, pasi kishin parë histori të ngjashme në televizion. Maria nuk tha as “po” e as “jo”, për t’i dhënë më shumë vlerë vetes para shoqeve si një person i veçantë.

Kur mbërritën në shtëpinë e prindërve, burri u tregoi përsëri albumin e Brazilit (me “z”), kontratën, ndërsa Maria u shpjegonte që kishte një sipërmarrës dhe kishte si synim të fillonte karrierën artistike. Duke parë kostumet e banjës që vishnin vajzat në fletëpalosjet që u dha i huaji, nëna ia ktheu menjëherë dhe nuk donte të bënte më pyetje: për të kishte rëndësi vetëm që e bija të ishte e lumtur dhe e pasur – ose jo e lumtur, por e pasur.

“Si quheni?”

“Roxher.”

“Ruxherio? Kam patur një kushëri me këtë emër!”

Burri buzëqeshi, rrahu duart dhe të gjithë e morën vesh se nuk kishte kuptuar asgjë. Babai i tha Maries:

“Po ai ka moshën time!”

Nëna iu lut të mos fuste hundët në lumturinë e vajzës. Si të gjitha rrobaqepëset, që janë të vetmet për të llapur gjatë me klientët e përftojnë mjaft njohuri në punët e dashurisë e të martesës, nëna e këshilloi: “Shpirti i nënës, më mirë jo e lumtur me një burrë të pasur, sesa të jetosh e lumtur me një varfanjak; atje do të kesh shumë mundësi të bëhesh një e pasur jo e lumtur. Tek e fundit, po nuk të eci merr tragetin dhe kthehu në shtëpi.”

Maria, që ishte në thelb një vajzë fshati e kishte një inteligjencë më të madhe se nëna apo burri i ardhshëm i imagjinuar, ia ktheu për ta provokuar:

“Nënë e ku vihet me traget nga Evropa në Brazil. Sidoqoftë, unë dua të kem një karrierë artistike, nuk jam në kërkim të një burri.”

Nëna e shikoi me një çehre gati të dëshpëruar:

“Në ka një mënyrë për të vajtur atje, ka edhe një mënyrë për t’u kthyer. Karrierat artistike janë për të rinjtë, por zgjasin derisa të kesh bukurinë, deri në të tridhjetat. Prandaj përfito: gjej një të ndershëm, që të do, e... të lutem... martohu. Nuk duhet menduar o dashuri, o rashë e vdiq: në fillim, edhe unë nuk e doja tët atë, por paraja blen gjithçka, deri edhe dashurinë e vërtetë. E mendo... babai yt nuk është as i pasur!”

Ishte një këshillë e keqe si shoqe, por një sugjerim i dobishëm si nënë. Dyzet e tetë orë më pas, Maria po

kthehej sërish në Rio, po më parë kishte kaluar te vendi i saj i punës për t'i njoftuar pronarit se do të linte punën:

“Kam marrë vesh se një sipërmarrës i madh francez ka vendosur të të marrë në Paris. Nuk mund të të pengoj të ndjekësh lumturinë tënde, por përpara se të shkosh, do të desha ta dije një gjë nga unë.”

Burri nxori nga xhepi një zinxhir me një medalje.

“Ky është një medalion mrekullibërës i Madona delle Grazie. Kisha e saj është në Paris; nëse të rastish të shkosh atje, kërkoi mbrojtje. Shiko çfarë është shkruar këtu.”

Maria lexoi fjalët e gdhendura rreth figurës së Virgjëreshës: “Oh, Maria e ngjizur pa mëkatuar, lutu për ne që përgjërohemi për Ty! Amen.”

“Kujtohu ta thuash këtë lutje të paktën një herë në ditë. Dhe...” Hezitoi pak, por arriti të fliste: “... nëse një ditë do të kthehesh, ta dish që unë po të pres. E humba rastin për të të thënë një gjë shumë të thjeshtë: të dua. Mbase është vonë, por desha që të paktën ta dije.”

“Të humbësh rastin”: Maria e kishte kuptuar shumë shpejt çfarë domethënie kishin këto fjalë. “Unë të dua”, ishte një frazë që e kishte dëgjuar shpesh në njëzet e dy vjetët e saj e, për të dukej se nuk kishte më asnjë kuptim, sepse pas saj nuk kish lindur kurrë ndonjë lidhje e thellë dhe e qëndrueshme. Vajza e falënderoi për ato fjalë që i nguliti në tru (ku i dihet ç’të sjell jeta, gjithmonë duhet ditur ku është rruga e shpëtimit), i dha një puthje të pastër në faqe dhe iku pa kthyer kokën.

U kthyen në Rio-de-Zhaneiro; brenda ditës ajo nxori pasaportën (“Brazili me të vërtetë ka ndryshuar”, kishte komentuar Roxher me ndonjë fjalë portugalisht dhe shumë gjeste, që Maria i përktheu me fjalët: “Dikur duhej më shumë kohë”). Me ndihmën e Mailsonit, përkthyesit/rojës trupore/sipërmarrësit, u kryen përgatitjet e fundit (fustane, këpucë, kozmetikë për makijazh, gjithçka mund të ëndërronte një grua si ajo). Roxher e vëzhgoi ndërsa vallëzonte në një lokal ku ndenjën në prag të nisjes për në Evropë: ishte entuziast: kishte gjetur një yll të vërtetë për kabarenë Coligny; një brune brilante me sy të kaltër, flokë pis si të zeza si krahët e *grauña* (një zog brazilian, që përdoret nga shkrimtarët për të krahasuar ngjyrën e zezë të flokëve). Kur konsullata zvicerane i lëshoi lejen e punës, bënë gati valixhet; të nesërmen ishin në udhëtim drejt tokës së çokollatave, orëve dhe djathit, me Marien që projektonte në fshehtësi ta marroste pas vetes atë burrë. Tek e fundit, nuk ishte as i vjetër, as i shëmtuar, as i varfër. E çfarë donte tjetër?

*M*aria mbërriti e mbaruar e, ndërsa po dilnin nga aeroporti, zemra iu ndrydh nga frika: zbuloi se varej tërësisht nga ai burrë që i ecte përbri – nuk njihte as vendin, as gjuhën, as atë të ftohtë. Sjellja e Roxherit kishte ndryshuar vetëm pas disa orësh. Tani nuk tregohej më i njerëzishëm: edhe pse nuk kishte tentuar asnjëherë as ta uthhte, as t’i prekte gjinjtë, shikimi i tij ishte tjetërsuar. E vendosi në një hotel të vogël, ku e prezantoi me një braziliane tjetër, një vajzë e re me çehre të trishtuar që quhej Vivian, e ngarkuar me përgatitjen e saj për punën e re.

Vivian e pa nga koka te këmbët: nuk kishte as më të voglin njerëzillëk apo mirëkuptim ndaj saj, që sikurse ajo, po jetonte eksperiencën e saj të parë jashtë vendit. Në vend që ta pyeste se si ndihej, hyri drejt e në temë:

“Iluzione mos të kesh. Ai burrë shkon në Brazil sa herë që njëra prej balerinave të veta martohet e, me sa duket, kjo po ndodh shpesh kohët e fundit. Ai e di mirë çfarë i duhet dhe besoj se e di edhe ti. Mendoj se ti ke ardhur këtu në kërkim të një prej këtyre tre gjërave: aventurë, pará ose burrë.”

E si e dinte? Mbase të gjitha kërkonin të njëjtn gjë, ose Vivian dinte të lexonte mendimet e tjetrit.

“Këtu, të gjitha vajzat janë në kërkim të një prej këtyre tri gjërave”, vazhdoi Vivian e Maria u bind se ajo ia lexonte mendimet. “Sa për aventurë, këtu bën shumë ftohtë e, pastaj nuk teprojnë mjaft para sa për të udhëtuar. Ndërsa përsa i takon parave, duhet të punosh gati një vit për të paguar biletën e kthimit, duke hequr veç shpenzimet e banesës dhe ushqimin.”

“Po...”

“E di, kjo nuk është në marrëveshjet. Në realitet, je ti që ke harruar të pyesësh, si gjithë të tjerat para teje. Po të ishte më e kujdesshme, po të kishe lexuar kontratën që ke firmosur, do ta dije mirë se ku ke ardhur; zvicëranët nuk gënjejnë dhe dinë të heshtin për qëllimet e tyre.”

Maries po i rrëshqiste toka nën këmbë.

“Përsa i takon burrit, çdo vajzë që martohet përbën për Roxherin një dëm të rëndë ekonomik, prandaj na është ndaluar të flasim me klientët. Nëse mendon të bësh diçka në këtë drejtim duhet të marrësh shumë rreziqe mbi sy. Ky nuk është një vend ku njerëzit takohen, si në Rue de Berne.”

Rue de Berne?

“Burrat vijnë këtu në shoqërinë e grave të tyre e, ata pak turistë që vijnë, sapo marrin vesh se ky është një mjedis familjar, shkojnë gjetiu të kërkojnë gra. Sforcohu të kërcësh mirë. Nëse di edhe të këndosh, rroga jote do të rritet e, me të, do të rritet edhe zilia e të tjerave. Prandaj,

edhe po të kesh zërin më të bukur të Brazilit, të këshilloj ta harrosh atë muhabet e mos të shkojë mendja të këndosh. Dhe, sidomos, mos e përdor telefonin. Do të shpenzosh të gjitha sa ke e do hysh në borxh.”

“Më ka premtuar pesëqind dollarë në javë!”

“Ta shohim.”

Nga ditari i Maries, javën e dytë të qëndrimit në Zvicër:

Isha në lokal, kam takuar një “drejtor të vallëzimit” që vjen nga një vend që quhet Marok e më është dashur të mësoj hap pas hapi atë që ai – që nuk ka shkelur kurrë në Brazil – e qun samba. Nuk kam pasur kohë as të çlodhem nga udhëtimi i gjatë në avion: duhet të qeshja dhe të vallëzoja, që mbrëmjen e parë. Femi gjashtë vajza: asnjëra prej kolegeve të mia nuk është e lumtur e asnjëra nuk e di se çfarë bën këtu. Klientët pijnë dhe duartrokasin, dërgojnë të puthura dhe, në fshehtësi, bëjnë gjeste të ndyra, por vetëm kaq.

Dje më paguan rrogën: gati një të dhjetën e shumës që kishim rënë dakord. Pjesa që mbetet, sipas asaj kontrate të famshme, do të shërbejë për të paguar biletën dhe banimin tim këtu. Në bazë të llogarive të Vivianit, kjo punë do të shkojë kështu një vit – shkurt muhabeti, gjatë kësaj periudhe nuk ka asnjë rrugëdalje.

Po a ia vlen t’ia mbathësh? Unë sapo kam ardhur e nuk njoh asgjë. Pastaj çfarë problemi ka të vallëzosh shtatë mbrëmje të javës? Më parë e bëja për qejf, tani e bëj për para dhe për famë. Këmbët nuk protestojnë, gjëja më e vështirë është të mbash buzëqeshjen në buzë.

Mund të zgjedh midis të qenit viktimë e botës, ose aventuriere në kërkim të thesarit të saj. Është thjesht një çështje që ka lidhje me mënyrën se si do ta përballoj jetën time.

*M*aria zgjodhi rrugën e aventurieres në kërkim të thesarit të saj: i la mënjanë ndjenjat, pushoi me të qarat çdo natë, harroi se kush ishte. Zbuloi në vetvete forcë vullneti të mjaftueshme për t’u shtirur si e porsalindur, pra nuk provonte kështu mall për askënd. Ndjenjat le të prisnin: tani duhet të fitonte pará, të njihte vendin dhe të kthehej fitimtare në tokën e saj.

Për më tepër, gjithçka e rrethonte i kujtonte Brazilin, qytezën e saj në veçanti, se edhe këtu vajzat flisnin portugalisht, ankoheshin për burrat, diskutonin me zë të lartë, protestonin për oraret, arrinin në lokal vonë, sfidonin pronarin, mbaheshin si më të bukurat e botës dhe tregonin për princat e tyre të kaltër – që përgjithësisht ishin larg, ose të martuar, apo nuk kishin pará sa duhet dhe jetonin me punën e tyre. Përkundër asaj që kishte imagjinuar kur kishte parë fletëpalosjet reklamë të Roxherit, mjedisi ishte krejt siç e kishte përshkruar Vivian: “familjar”. Vajzat nuk mund të pranonin ftesa ose të dilnin me klientët, sepse në librezat e punës ishin të regjistruara si “balerina të sambas”. Nëse kapeshin me ndonjë biletë me numër telefoni pezulloheshin për

pesëmbëdhjetë ditë. Maria, që priste më shumë lëvizje dhe diçka më emocionuese, pak e nga pak u kaplua nga trishtimi dhe mërzia.

Gjatë ditëve të para, doli shumë pak nga pensioni ku banonte, mbi të gjitha, kur mësoi se askush nuk e kuptonte gjuhën e saj, madje edhe kur ajo i shqiptonte fjalët krejt ngadalë. U habit shumë kur mori vesh se, ndryshe nga ç'ndodhte në vendin e saj, qyteti ku banonte tani thirrej me dy emra të ndryshëm: “Gjeneva” për banorët e vet dhe “Gjenebra” për brazilianët.

Më në fund, në ato orët e gjata e të mërzitshme që kaloi në dhomëzën e saj përpara televizionit, arriti në përfundimin se:

a) Nuk do ta gjente kurrë atë që kërkonte nëse nuk do të mund të shprehte atë që mendonte (kështu, duhej mësuar gjuha e vendit);

b) Duke parë se të gjitha shoqet e veta ishin në kërkim të afirmimit personal, ajo duhej të ishte ndryshe (por, ende nuk kishte bërë një plan ose metodë për t'ia dalë mbanë).

Nga ditari i Maries, katër javë pas zbarkimit në Gjenevë/Gjenebra:

Ndodhem këtu tanimë prej shumë kohësh e nuk e flas ende gjuhën vendase; i kaloj ditët duke dëgjuar muzikë në radio, duke parë muret e dhomës, duke menduar Brazilin, e gjithmonë duke pritur me padurim që të vijë orari i punës e, kur jam në punë, që të vijë sa më shpejt ora e kthimit në pension. Po rroj në të ardhmen dhe jo në të tashmen.

Një ditë, në një të ardhme të largët, do të kem një biletë avioni për t'u kthyer në Brazil, të martohem me pronarin e dyqanit të pëlhurëve, nën komentet e liga të shoqeve të mia që nuk kanë rrezikuar kurrë e kështu arrijnë të shikojnë vetëm humbjen e tjetrit. Jo, nuk mund të kthehem kështu. Preferoj më mirë të hidhem nga avioni drejt e në oqean.

Po dritaret e avionit nuk hapen (e pra, këtë nuk e prisja; sa gjynah që nuk mund të ndjesh ajrin e pastër!), kështu që do të vdes këtu. Por, përpara se të vdes, dua të luftoj për jetën. Nëse bëhem e zonja të eci me këmbët e mia mund të shkoj ku të dua.

*T*ë nesërmen, Maria u regjistrua në një kurs leksionesh të frëngjishtes që bëhej në mëngjes, ku njohu njerëz të të gjithë ideve politike, feve dhe moshës: Burra me veshje ngjyra-ngjyra e zinxhirë të artë në duar, gra me ferexhe; fëmijë që mësonin shumë më shpejt se të rriturit – kur duhej të ndodhte e kundërta, se të rriturit kanë më shumë përvojë. Ndihej krenare ngaqë të gjithë e njihnin vendin e saj, karnavalet, *samba*-n, futbollin dhe njeriun më të famshëm të botës, Pelè. Në fillim donte të ishte simpatike me të tjerët dhe ua korrigjonte shqiptimin (“Thuhet Pelè! Pelèèè!”), por më vonë u tërhoq, përderisa edhe ajo thirrej “Marià” – me atë maninë e të huajve për të transformuar emrat duke menduar se e kanë në rregull!

Pasdite, që të mbetemi përsëri te gjuha, bëri një shëtitje në këtë qytetin me dy emra dhe zbuloi një çokollatë të mrekullueshme, një djathë që nuk e kish provuar kurrë, një burim gjigant në mes të liqenit, borën (këmbët e asnjë banori të vendlindjes së saj nuk e kishin shkelur ende borën), lejlekët, restorantet me oxhak (nuk kishte hyrë kurrë, vetëm kishte parë zjarrin nga dritaret e kjo i kishte krijuar një ndjesi të këndshme mirëqenieje). U habit,

sidomos, kur zbuloi se jo të gjitha afishet e reklamave ishin për orët, por dukeshin edhe bankat – por nuk arrinte të kuptonte përse kishte kaq pak njerëz rrotull e rrallë shikonte klientë brenda agjencive: megjithatë vendosi të mos pyeste për asgjë.

Pas tre muajsh vetëkontrolli në punë, gjaku i saj brazilian, sensual dhe erotik, siç mendojnë të gjithë, filloi të ngrinte krye: Maria u dashurua me një arab që frekuentonte me të kursin e frëngjishtes. Historia me të zgjati tre javë derisa, një mbrëmje, ajo vendosi ta linte atë muhabet dhe shkoi në piknik në një malësi afër Gjenevës. Kur u kthye në punë, pasditen tjetër, Roxheri e thirri në zyrë.

Sapo hapi derën, Maria mësoi se ishte pushuar në vend nga puna, pasi kishte dhënë një shembull të keq për vajzat e tjera që punonin aty. Roxheri, histerik, i tha se edhe një herë tjetër kish mbetur i zhgënjyer, te vajzat braziliane nuk mund të kesh pikë besimi (o Zot, kjo mania për të përgjithësuar!). Nuk piu ujë fare që ajo i tha se kishte pasur ethe nga ndryshimi i temperaturës; burri nuk u bind dhe, ndërkaq, u qa se duhej vajtur edhe një herë në Brazil për të gjetur një zëvendësuese, duke shtuar se do të bënte më mirë sikur të organizonte një spektakël me muzikë e balerina sllave, më të këndshme dhe më të përgjegjshme.

Pavarësisht nga mosha e re, Maria nuk ishte ndonjë e paqenë – sidomos që kur i dashuri i saj arab i kishte shpjeguar se në Zvicër ligjet mbi punën ishin shumë

të rrepta; ajo mund të ankohej se puna e saj i ngjante skllavërisë, pasi lokali i mbante pjesën më të madhe të rrogës.

U kthye në zyrën e Roxherit e këtë radhë foli me një frëngjishte të saktë, që përfshinte në fjalor edhe termin “avokat”. Doli me ndonjë fjalë përçmuese dhe pesë mijë dollarë dëmshpërblim – një shumë që as e kishte ëndërruar ndonjëherë – e gjithçka falë fjalës magjike. “avokat”. Tani mund ta takonte sa herë të donte arabin, të blinte disa dhurata, të bënte ndonjë fotografi në dëborë dhe të kthehej në vendin e saj me fitoren aq të dëshiruar.

Si fillim, i telefonoi një mikeshë në Brazil që banonte pranë shtëpisë së saj që t’i thoshte nënës se ajo ishte e kënaqur, se kishte përpara një karrierë brilante, prandaj ajo me babanë nuk duhet të shqetësoheshin. Pastaj, ngaqë do të linte dhomën që Roxheri kish marrë me qira, i mbetej vetëm një rrugëzgjdhje: të shkonte tek arabi, t’i betohej për dashuri të përjetshme, të kthehej në fenë e tij dhe të martohej – edhe pse do t’i duhej të mbante në kokë një nga ato velet e çuditshme. Në fund të fundit, të gjithë e dinin se arabët ishin të pasur dhe kjo mjaftonte.

Por, në atë çast, arabi i saj i dashur ishte larg, mbase në Arabi, një vend që Maria nuk e njihte. Dhe kështu falënderoi Madonën që nuk do të ishte e shtrëguar të ndërronte fenë e vet. Tani, të paktën, me frëngjishten ia dilte mbanë, kishte para për biletën e kthimit, kishte një librezë pune që e përcaktonte si “balerinë të sambas”, zotëronte leje qëndrimi ende të vlefshme dhe e dinte se

mund të martohej me një tregtar pëlhurash: duke marrë në konsideratë të gjitha këto, vajza e re vendosi të bënte diçka për të cilën ishte e sigurt se do t'ia dilte mbanë: të fitonte pará me bukurinë e saj.

Në Brazil kishte lexuar një libër për një bari, i cili has shumë vështirësi në kërkim të thesarit të tij, por më në fund e arrin atë që dëshiron. Ishte si rasti i saj. Tani ishte tërësisht e bindur se kish ardhur ora që ajo të pushohej nga puna për të takuar fatin e saj: të bëhej modele ose paraqitëse e modës së veshjeve.

Mori me qira një dhomë të vogël (pa televizion, sepse duhej të kursente derisa të fitonte pará sa duhej) dhe, të nesërmen, filloi të sillej rrotull agjencive. Kudo i thoshin se duhej të linte fotografi të bëra nga profesionistë. Në fund të fundit, ishte një investim për karrierën – ëndrrat kushtojnë. Shpenzoi pjesën më të madhe të parave për një fotograf të njohur, që fliste pak e kërkonte shumë: në studio kishte një gardërobë shumë të pasur, ajo pozoi me fustane seriozë dhe ekstravagantë, madje edhe me kostum banjoje bikini, për të cilin i njohuri i saj i vetëm në Rio, përkthyesi/roja trupore dhe ish-sipërmarrësi Mailson, do të ishte krenar. Kërkoj disa kopje më tepër që ia dërgoi familjes bashkë me një letër ku u thoshte se ishte e lumtur në Zvicër. Prindërit e saj do të mendonin se ishte e pasur, se zotëronte një garderobë për ta pasur zili, që ishte tanimë vajza më e famshme e qytezës. Po të shkonte gjithçka siç mendonte ajo (kishte lexuar në sa e sa libra mbi “mendimin pozitiv” që nuk kishte as

dyshimin më të vogël në fitore), në kthim do ta prisnin me bandën muzikore; pastaj do t'i mbushej mendja kryetarit të bashkisë t'i vinte një sheshi të qytezës emrin e saj.

Bleu një celular (me një skedë të parapaguar, sepse nuk kishte një banesë fikse) dhe, në ditët që pasuan, mbeti në pritje që ta thërrisnin për punë. Hante në restorantet kineze (më të lirët) dhe, për të kaluar kohën studionte me një impenjim të çmendur.

Por koha ecte ngadalë dhe telefoni nuk binte. Ishte e habitur nga fakti që kur kalonte përbri liqenit, askush nuk i kushtonte vëmendje, përveç disa trafikantëve të drogës që qëndronin gjithmonë në të njëjtin vend, poshtë njëres nga urat që lidhte kopshtin e bukur antik me pjesën më të re të qytetit. Filloi të dyshojë për bukurinë e saj, derisa njëra nga shoqet e vjetra të punës, me të cilën ishte takuar në një bar, i tha se nuk ishte faji i saj, por kishte të bënte me zviceranët që nuk ngacmonin, qoftë edhe të huajt, sepse kishin frikë se arrestoheshin për “ngacmime seksuale” – një shprehje që e kishin shpikur me qëllim që gratë e gjithë botës të ndiheshin të urreyera.

Nga ditari i Maries, në njërën nga mbrëmjet kur nuk kishte kurajo të dilte, të jetonte, të vazhdonte të priste një telefonatë që nuk po vinte:

Sot kalova përpara luna-parkut. Por, meqë nuk mund ta prish paranë kot, u ndala vetëm për të vëzhguar njerëzit. Mbeta gjatë përpara maleve ruse: shikoja se pjesa më e madhe e njerëzve ngjitej në kërkim të emocioneve, por kur vagonët fillonin të lëviznin, të gjithë kishin një frikë të tmerrshme dhe kërkonin që të ndalonte lëvizja.

Çfarë duan? Nëse kanë zgjedhur aventurën, a nuk duhej të ishin të përgatitur për ta çuar deri në fund? Apo mendojnë se do të ishte më inteligjente t'i linin këto ulje-ngritje dhe të rrotulloheshin në një karusel?

Për momentin jam shumë e vetmuar që të mendoj për dashurinë, por duhet ta bind veten se gjithçka do të kalojë, se do të gjej një punë, pasi ndodhem këtu për të ndjekur fatin tim. Ekzistenca ime është si malet ruse – po, jeta është një lojë e fortë dhe halucinante, jeta është si të hidhesh me parashutë, të rrezikosh, të rrezohesh e të ngrihesh përsëri, është alpinizëm, të thotë se duhet arritur maja dhe të lë të pakënaqur dhe gjithë ankth kur nuk ia arrin.

Nuk është e lehtë të jetosh larg familjes, të mos flasësh gjuhën me të cilën di t'i shprehësh gjithë ndjenjat dhe emocionet e tua, por që sot, kur të jem e mërzitur, do të sjell në mend atë pakun e argëtiveve. Po të isha në

gjumë dhe të zgjohesha befas mbi malet ruse, çfarë do të kisha ndier?

Po, ndjesia ime e parë do të ishte ajo e të qenit e burgosur: e terrorizuar nga kthesat, do të doja të villja e t'ia mbathja që andej. Por, nëse do të kisha besim, do të thosha që binarët janë fati im, është Zoti që po e drejton vagonin dhe ky makth do të transformohet në ekstazë. Do të ndodhë tamam si në realitet: joshja nga malet ruse, një argëtim i sigurt dhe i besueshëm që do të ketë gjithmonë një stacion nisjeje. Por, ndërkohë që lëvizja vazhdon, unë duhet të shikoj peizazhin që më rrethon dhe të ulërij nga eksitimi.

Gjërat që shkruante, Maria, i konsideronte shumë të mençura, por ja që nuk i vinte dot në jetë. Momentet e depresionit po bëheshin më të shpeshta, telefoni vazhdonte të mos binte. Për ta humbur mendjen filloi të blejë revista të ndryshme në frëngjisht. Pastaj, duke e kuptuar se po prishte shumë pará, u vu në kërkim të bibliotekës më të afërt. Bibliotekarja i thotë se nuk mbanin revista: sidoqoftë ajo i sugjeroi disa tituj që do ta ndihmonin në përmirësimin e frëngjishtes.

“Nuk kam kohë të lexoj libra.”

“E si nuk ke kohë? Çfarë bën?”

“Shumë gjëra: studioj frëngjisht, shkruaj një ditar dhe...”

“Dhe... çfarë?”

Donte të thoshte: “Po pres që të bjerë telefoni”, por preferoi të heshtë.

“Ti je e re moj bijë, e ke gjithë jetën përpara. Harroji ata që shajnë librat dhe lexo.”

“Kam lexuar shumë.”

Papritur i erdhi në mend ajo që Mailsoni ia kishte përshkruar një herë si “energji”. Bibliotekarja iu duk një grua e ndjeshme, e ëmbël, një njeri që mund ta ndihmonte nëse e ardhmja e saj do të ishte falimentim. Duhet ta bënte për vete: intuista e saj i thoshte se tek ajo mund të gjente një mike. Ndërroi menjëherë:

“Por dua të lexoj ende. Të lutem, më ndihmo të zgjedh ndonjë libër.”

Gruaja i solli “Princi i Vogël”. Po atë mbrëmje, Maria filloi ta shfletojë, pa vizatimet e faqeve të para, ku dukej një kapele: por autori thoshte se ishte në të vërtetë një gjarpër me një elefant brenda: ‘Jo, unë nuk kam qenë kurrë fëmijë,’ mendoi me vete. ‘Mua me ngjan me një kapele.’ Në mungesë të televizorit, filloi të shoqëronte Princin e Vogël në udhëtimet e tij, po kur nganjëherë trajtohej tema e dashurisë trishtëhej – i ishte ndaluar të mendonte për këtë temë, përndryshe mund të vriste veten. Edhe pse me skena romantike me një princ, një dhelprë dhe një trëndafil, libri ishte shumë interesant, prandaj ajo kujtohej e terrorizuar të kontrollonte herë pas here nëse bateria e celularit ishte e karikuar (nuk mund t’i ikte rasti i madh i jetës së saj për një mungesë vëmendjeje).

Maria filloi të frekuentojë bibliotekën, të bëjë muhabet me bibliotekaren, që dukej një grua po aq e vetmuar sa edhe ajo, i kërkonte sugjerime, diskutonin për jetën e për

autorë të ndryshëm. Kursimet e saj u pakësuan shumë. Edhe dy javë pastaj nuk do t'i mbeteshin më pará as për biletën e kthimit.

Jeta pret situatat më kritike për të shfaqur anën e vet më brilante. Më së fundi, ra telefoni.

Tre muaj pasi kish zbuluar fjalën “avokat” e dy muaj që i kaloi duke u mbajtur me dëmshpërblimin e fituar, një agjenci modelesh pyeti nëse zonja Maria gjendej ende në atë numër. Përgjigja ishte një “po” e akullt dhe e prerë, për të mos lënë të kuptohej asnjë notë shqetësimi. Mësoi që një arab, stilist i famshëm në vendin e tij, i kishte pëlqyer shumë fotot e saj dhe donte ta ftonte të merrte pjesë në një sfilatë. Ky ishte një zhgënjim i ri për Marien, por mendoi për paratë për të cilat kishte kaq nevojë.

Sajuan një takim në një restorant shumë luksoz. Iu shfaq përpara një zotëri krejt elegant, shumë më joshës dhe i pjekur se maestro i ballos samba. Pas një copë here e pyeti:

“A di të më thuash i kujt është ky kuadër? I Juan Mirò-së! E di ti kush është Juan Mirò?”

Maria rrinte e heshtur, sikur ta kishte mendjen vetëm tek ushqimi, shumë më i ndryshëm nga ai i restoranteve kinezë. Ndërkohë, po mendonte se herën tjetër në bibliotekë duhej të merrte një libër për Mirò-në.

Arabi këmbënguli në bisedë:

“Ajo tavolina atje ishte e preferuara e Federico Fellinit. Çfarë mendon për filmat e Fellinit?”

Ajo iu përgjigj se i adhuronte. Por kur burri bëri të zbriste në detaje, Maria, duke e ditur që kultura e saj nuk do ta kalonte provimin, vendosi të hynte direkt në temë:

“Unë nuk kam ndër mend të rri këtu si ndonjë budallaçkë. E gjithë ajo që di është se di të dalloj një Coca-Cola nga një Pepsi. Po ju, nuk kishit ndër mend të flisnit për një sfilatë mode?”

Singeriteti i vajzës së re u duk që e preku arabin.

“Do t’ju flas, kur të shkojmë të pijmë diçka pas darkës.”

Ra heshtje. Të dy u panë, secili me idenë për të zbuluar se çfarë mendonte tjetri.

“Je shumë e ëmbël”, i tha arabi. “Nëse pranon të vish në hotel me mua për të pirë diçka, të dhuroj një mijë franga.”

Maria i ra në të menjëherë. A ishte faji i agjencisë së modeleve? Apo ndonjë gabim i saj: mos duhet të informohej mirë në lidhje me darkën? Nuk ishte faji i agjencisë, as i saj, as i arabit: gjërat funksiononin pikërisht në këtë mënyrë. Befas, ndjeu se i mungonte *sertào*, Brazili, dashuria e nënës. I erdhi në mend informacioni i Mailsonit kur, në plazh, i kishte folur për treqind dollarët. Atëherë i ishte dukur argëtuese e shifra goxha e lartë për të kaluar vetëm një mbrëmje me një burrë. Kurse tani, e kuptoi se nuk kishte askënd me të cilin të fliste: ishte e vetme, në një qytet të huaj, me njëzet e dy vitet e saj të kaluara në një mënyrë të këndshme, por të panevojshëm për ta ndihmuar të gjente përgjigjen më të mirë.

“Më hidh prapë verë, të lutem!”, tha.

Arabi i hodhi përsëri verë në gotë, ndërsa mendimi i Maries ecte më shpejt edhe se ai i Princit të Vogël në udhëtimin e tij midis planeteve. Kishte ardhur të kërkonte aventurën, paranë, mbase edhe burrë. E dinte se do t’i ndodhnin propozime të kësaj natyre, ajo nuk ishte fare, tanimë ishte e mësuar me sjelljen e burrave. Agjencitë e modeleve, suksemi, një burrë i pasur, familja, fëmijët, nipërit, rrobat e shtrenjta dhe një kthim fitimtar në vendlindje... , po, besonte akoma në të gjitha këto. Ëndërronte të kapërcente çdo vështirësi vetëm me inteligjencë, joshje dhe forcë vullneti.

Por realiteti i ishte rrënuar para syve. Për habinë e arabit, Maria ia dha të qarit. Në mëdyshje midis frikës së skandalit dhe instinktit mbrojtës të mashkullit, burri nuk dinte ç’të bënte. Kur i bëri me shenjë kamerierit që të sillte llogarinë, vajza e ndaloi:

“Prit edhe pak. Më jep prapë verë dhe më lër të qaj edhe ca.”

E i shkoi mendja te djali që i kishte kërkuar një penë, tek i riu që e kishte puthur me gojën mbyllur, te hareja e vajtjes në Rio-de-Zhanejro, te burrat që e kishin përdorur pa i dhënë asgjë, te pasionet dhe dashuritë e humbura gjatë jetës së saj. Për të, jeta, pavarësisht nga liria në sipërfaqe, ishte një pritje e pafund duke shpresuar një mrekulli, në një dashuri të vërtetë, në një aventurë me epilog romantik që e kishte parë aq herë në filma e lexuar nëpër libra. Dikush ka shkruar se nuk është as koha, as

mençuria që e transformojnë njeriun: e vetmja gjë që e shtyn atë të ndryshojë, është dashuria. Çfarë budallallëku! Kush i ka shkruar këto fjalë njeh vetëm njërën anë të medaljes.

Në realitet, dashuria është *e para* gjë e aftë të ndryshojë tërësisht jetën e një njeriu nga një moment në tjetrin. Por është edhe ana tjetër e medaljes – pra, gjëja *e dytë* që e shtyn një njeri në një drejtim krejt tjetër nga ai që ka projektuar: dëshpërimi. Po, mbase dashuria është e aftë të ndryshojë një njeri, por dëshpërimi prodhon një ndryshim më të shpejtë. E tani, Maria?... Duhej të nisej menjëherë, të kthehej në Brazil, të jepte mësimë frëngjishteje, të martohej me pronarin e pëlhurave? Kjo që po ndodhte: ishte një rast që nuk duhej humbur, apo një provë që i kish vënë përpara Virgjëresha?

Shikimi i arabit ndali në kuadrin e Juan Mirò-së, mbi tavolinën ku hante darkë Fellini, mbi gardarobieren e re, mbi klientët që hynin e dilnin.

“Nuk e prisje?”

“Më hidh prapë verë, të lutem”, ishte përgjigjja e Maries ende me lot.

Vajza luste të mos afrohej kamerieri e të merrte vesh ç’po ndodhte. Ndërsa ky, vrojtonte skenën nga larg me bisht të syrit në pritje që burri në shoqërinë e asaj vajze të paguante menjëherë llogarinë e të lironte tavolinën për klientët e tjerë që prisnin.

Më në fund, pas një periudhe kohe që u duk e përjetshme, Maria foli:

“The një pije për një mijë franga?”

Edhe vetë u habit me tonin e zërit.

“Po”, u përgjigj arabi që tani ishte penduar për atë propozim. “Por nuk dua absolutisht...”

“Pago llogarinë. Shkojmë në hotelin tënd ta hedhim këtë gotë.”

Përsëri, Maria kishte përshtypjen se po e njihnte veten. Deri tani kishte qenë një vajzë e njerëzishme, e edukuar, e qeshur, që nuk do ta përdorte kurrë atë ton zëri me një të panjohur. Tani i dukej se ai njeri kishte vdekur përgjithmonë: përpara saj ishte një jetë tjetër, kur pija kushtonte një mijë franga ose, në një monedhë tjetër më të njohur, gjashtëqind dollarë.

Gjithçka shkoi sipas parashikimit: Maria shkoi në hotel me arabin, piu shampanjë derisa gati u deh, hapi këmbët, priti që ai të arrinte orgazmën (nuk u kujtua të bënte sikur edhe ajo u kënaq), u la në banjon e mermertë, mori paratë dhe i lejoi vetes luksin e një taksie deri në shtëpi.

Ra në shtrat dhe bëri një gjumë pa ëndrra.

Nga ditari i Maries, ditën tjetër:

Kujtoj gjithçka, përveç momentit kur mora vendim. Është kurioze, por nuk ndiej asnjë sens faji. Përpara, mendoja se vajzat shkonin në shtrat për pará, sepse jeta nuk u kishte ofruar asnjë shans. Por tani e kuptoj që nuk është kështu. Unë mund të thosha edhe po edhe jo, askush nuk më detyronte të pranoja.

Eci në rrugë, shikoj njerëzit: a e ka zgjedhur secili prej tyre rrugën e jetës? Apo edhe për ta ka zgjedhur “fati”? Shtëpiakja që ëndërronte të bëhej modele, drejtori i bankës që donte të bëhej muzikant, dentisti që kishte një libër në sirtar se donte t’i kushtohej letërsisë, vajza që do të dëshironte të punonte në televizion, por që ka gjetur vetëm një punë si arkëtare në supermarket...

Nuk më vjen aspak keq për veten. Vazhdoj të mos ndihem viktimë, sepse mund edhe të ikja nga restoranti me dinjitetin e pacenuar dhe portofolin bosh. Mund t’i jepja një leksion morali burrit që ishte ulur përballë meje, ose t’i lija të kuptonte se kishte përballë një princeshë, të cilën duhet ta fitonte dhe jo ta blinte. Mund të sillesha në një pafundësi mënyrash, e në fakt, si pjesa më e madhe e qenieve njerëzore, lashë fatin të zgjidhte rrugën që duhej të merrja.

Nuk jam e vetmja, edhe pse fati im duket negativ dhe i veçuar nga ai i të tjerëve. Por, në kërkimin e lumturisë, jemi të gjithë në të njëjtin nivel: drejtori-muzikant, dentisti-shkrimtar, arkëtarja-aktore, shtëpiakja-modele... Askush prej nesh nuk është i lumtur.

*K*aq ishte puna? Ishte kaq e lehtë? Maria gjendej në një qytet të huaj, ku nuk njihnte njeri dhe ajo që për të dje mund të quhej një tërmet, sot i jepte një ndjesi të pakufi lirie: nuk do t'i jepte shpjegime askujt.

Vendosi që, për herë të parë në jetën e saj, t'ia kushtonte të gjithë ditën vetvetes. Deri atëherë, kishte jetuar duke menduar për të tjerët – nëna, shoqëria e shkollës, babai, nëpunësit e agjencisë së modeleve, profesori i frëngjishtes, kamerieri, bibliotekarja – ose duke u shqetësuar se çfarë do të mendonin të panjohurit që kalonin në rrugë. Në të vërtetë askush nuk e çante kokën, e kush ia varte asaj, një e huaj e mjerë, që edhe sikur të zhdukej të nesërmen, policia as që kishte për ta kërkuar.

Mjaft më. Doli herët, hëngri mëngjesin në barin e zakonshëm, shëtiti përgjatë liqenit, ndeshi në një manifestim emigrantësh. Një grua me qen i tha se ishin kurdë; edhe kësaj radhe, në vend që të bënte sikur dinte e të tregohej më inteligjente dhe me kulturë sesa mendonin të tjerët, Maria pyeti:

“Nga vijnë kurdët?”

E habitur, gruaja nuk diti të përgjigjej. Kështu shkon bota: njerëzit flasin sikur të njihnin gjithçka dhe, kur i pyet, nuk dinë gjë prej gjëje. Hyri në një kiberkafë dhe zbuloi në Internet se kurdët vinin nga Kurdistan, një vend që nuk ekzistonte, ndarë midis Turqisë dhe Irakut. U kthye në vendin ku ishte më parë, duke shpresuar të gjente gruan me qen, por nuk e pa më: mbase kishte ikur se qeni nuk do të kish duruar të rrinte duke parë njerëz me banderola, çarçafë, muzikë dhe ulërima të çuditshme.

‘Ja si jam unë. Ose më mirë, si isha: një njeri që bënte sikur i dinte të gjitha, e mbyllur në heshtjen time, derisa ai arabi më nxehu aq shumë, sa i thashë se dija vetëm të dalloja Coca-Cola-n nga Pepsi. Do të jetë shokuar? Do të ketë ndërruar mendje për mua? Çne, atij i pëlqeu spontaniteti im! Sa herë jam treguar dinake, kam humbur: tani mjaft!’

Iu kujtua agjencia e modeleve: o ata e dinin se çfarë kërkonte arabi – pra, ajo ishte treguar edhe një herë e trashë - ose mendonin se ai do t’i propozonte vërtet një punë jashtë.

Sidoqoftë, Maria ndihej më pak e vetmuar në atë mëngjes gri të Gjenevës: me temperaturën afër zeros, kurdët që manifestonin, tramvajet që arrinin gjithmonë në orar në çdo stacion, dyqanet që rivendosnin zbukurimet nëpër vitrina, bankat që hapeshin, lypësat që flinin dhe zvicëranët që nxitonin për në punë. Ishte më pak e vetmuar, sepse përbri saj ecte një grua tjetër, mbase e